



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 29.03.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen -

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Marrin pjesë² :

- | | |
|--------------------------|-----------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 6. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 7. Medi Bici | (anëtar zëvendësues) |
| 8. Klodiana Veizi (Mema) | (anëtare zëvendësues) |

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Enio Haxhimihali, përfaqësuesi i Avokates së Popullit.

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

² Anëtarja e Fatjona Memçaj nuk merr pjesë në diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore normative, për shkak të papajtueshmërisë-marrëdhënie krushqie e afërt me kandidaten Ardita Alsula. Sipas ligjit, Kryetari i Këshillit e ka miratuar heqjen dorë me vendimin nr.1 datë 14.02.2019.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016 :

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.
2. Mimoza Arbi, përfaqësuese e Kryetarit të Kuvendit

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :

1. Agnes Bernard, shefe e misionit EURALIUS
2. Julinda Beqiraj, eksperte e EURALIUS
3. Maniela Sota, Koço Bendo, përkthyes për EURALIUS

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Në mbledhje nuk merr pjesë anëtar i zëvendësues i Këshillit, zoti Gurali Brahimllari, i cili, sipas njoftimit, e ka të pamundur pjesëmarrjen për shkak të pjesëmarrjesh së detyrueshme në proece penale jashtë qytetit të Tiranës, sipas aktit të delegimit të KLGJ.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen me pjesën tjetër të dispozitave të pashqyrtuara të projektvendimit normativ *Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*, më konkretisht me projektshtojcat mbi kriteret e vlerësimit dhe metodologjinë e pikëzimit të kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese dhe atë për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

Ardian Dvorani, si relator i projektaktit, duke pasur parasysh edhe se diskutimet parimore mbi shtojcat ishin zhvilluar në mbledhjen e Këshillit të datës 11.03.2019, për qëllime të orientimit të diskutimit bën një parashtrim hyrës për punën e kryer për përgatitjen dhe përmirësimin e projektshtojcave dhe mbi elementët thelbësore të këtyre dy akteve. Pas

parashtrimin hyrës, meqenëse për hartimin e projektshtojcave sikurse edhe për vetë projektvendimin normativ bashkëpunohet me Euralius. Pasi merr miratimin e anëtarëve, i kërkon **Agnes Bernhard** të parashtrojnë mendimet e tyre mbi këto projektshtojca, e para për mënyrën se si të procedojmë dhe e dyta në parim cili është mendimi juaj mbi përmbajtjen e shtojcave. Nëse, po do e themi hapur, se keni pasur dhe kohën për ta pjekur mendimin tuaj.

Agnes Bernhard (*përkthen përkthyesja*), mbi kërkesën e anëtarëve të Këshillit për të dhënë mendime, merr fjalën dhe parashtron se për vetë kohën e shkurtër në dispozicion për të shqyrtuar variantin e përmirësuar të projektshtojcave mendimet nuk mund të jenë për momentin shumë të thelluara. Mendoj që ky akt i dhënies së pikëve është një nga më të rëndësishmit që ju duhet të miratoni. Pra, duhet të gjeni atë baraspeshim, si të thuash, që të shndërroni atë që është katror ta bëni rreth. Mendoj që është mirë që të shprehen të gjitha mendimet në mënyrë që të gjendet më e mira por duhet parë edhe si proces. Natyrisht që këto tabela të përgatitura janë produkt i konsideratave që në kemi patur për këtë proces. Në vijim po japim edhe disa konsiderat tepër të përgjithshme. Pra, janë 3 seksione që edhe ju i shprehet. Për ne janë shumë të rëndësishme meritata profesionale, morale dhe menaxhuese. Ndërsa duhet pasur parasysh që kur kemi të bëjmë me një gjyqtar kushtetues, atëherë aftësitë e tij menaxheriale nuk është se duhet të jenë parësore. Kështu që edhe caktimi i pikëve duhet të jetë proporcional me këtë. Jam paksa e shqetësuar në lidhje me caktimin e pikëve për meritat profesionale dhe për integritetin. Sepse ai kandidat i cili nuk merr pikët dhe nuk e ka integritetin e duhur, nuk duhet të ketë mundësinë të renditet tek 3 të parët dhe nuk mendoj se kjo është e garantuar, duke patur parasysh që këtu janë 20 pikë dhe pastaj janë 70 pikë, pra 90. Pra, dikush mund të jetë me integritet në pikëpyetje por profesionalisht dhe nga pikëpamja menaxheriale mund të jetë shumë mirë. Kështu ai mund të renditet mbi të tjerët, ta tejkalojë këtë. Edhe përse i takon të dhënave profesionale bëhet një dallim midis 3 sferave kryesore. Me një lexim shumë të thjeshtë dhe të shpejtë më duket sikur janë gjëra që janë mbivendosur, sikur përsëriten dhe duket sikur një kategori e caktuar kandidatësh mund të vendosen një pikë fillestare të avantazhuar kundrejt të tjerëve. Pra, këtë mund të them me një shikim të shpejtë. Por më duket se janë caktuar shumë pikë dhe kjo nuk sjell si rezultat një vlerësim shumë kompleks të kandidatit. Përpara sesa të shikoni konkretisht këtë tabelë mbase do të ishte më mirë të bëjmë një diskutim teorik se ku duhet të jetë qendra e rëndësës. Psh. Për një kandidat cilat cilësi duhet të kishte teorikisht dhe pastaj të caktonit ato kategori. Ky është si reagimi i parë.

Anëtarët e Këshillit vijojnë me diskutime të natyrës së përgjithshme dhe parimore për projektshtojcat e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve duke u dakordësuar vijimin e diskutimit në parim, për strukturën e projektit, ndarjen në tre pjesë meritave profesionale, morale dhe

menaxhuese, kujdesin për peshat specifike të tyre, shpërndarjen e pikëve për secilën kategori dhe kriter të meritave dhe për nënndarjet e secilës kategori, shtimin e pikëve tek kriteri moral dhe më shumë balancë vlerësimi mes vjetërsisë dhe aftësive profesionale të përgjithshme dhe të posaçme.

Agnes Bernhard (*përkthen përkthyesja*), merr fjalën dhe parashtron se lidhur me meritat morale nëse nuk vendoset pragu i përshtatshmërisë atëherë skema duhet të ndryshojë dhe kriteret morale duhet të kenë numër më të madh pikësh, të kenë peshë shumë më të lartë. Pikerisht mungesa e këtij pragu na bën që të kemi këtë sfidë, të përballemi edhe me një person që është majft i kualifikuar nga ana profesionale që mund të kompensojë mangësitë që ka në aspektin e integritetit. Ndaj edhe 20 pike për meritat morale mund të duken edhe pak. Nga ana tjetër problemi në vlerësimin e aspektit moral siç u përmend është natyra subjektive dhe duke i vendosur shumë pikë njëkohësisht ekspozoni më shumë veten ndaj subjektivizmit. Prandaj duhet gjetur balanca dhe duhet të sigurojme që edhe dikush që merr pike të larta profesionale por nuk merr pike në anën morale nuk duhet të kalojë dhe nuk duhet të renditet lart. Sigurisht një zgjidhje për aspektin moral është të përdoret skema e zbritjes së pikëve nga maksimumi i prezumuar.

Në lidhje me vjetërsinë ka standarte shumë të qarta evropiane, gjithashtu ka edhe rekomadime nga Këshili i Europës. Dmth vjetërsia nuk duhet të jetë qendër e vlerësimit. Natyrisht që vjetërsia është shumë e rëndësishme sepse sa më shumë eksperiencë që individi të ketë, aq më cilësore do të jetë puna e tij. Pra, natyrisht që nëse bëhet vlerësimi i saktë i performancës atëherë nëse shikohet se me kalimin e viteve dikush përmirësohet, detyrimisht që edhe vjetërsia do të ketë më shumë peshë. Ndërsa vjetërsia në ligj përmendet në një aspekt tjetër. Në qoftë se, pikëzimi i kandidatëve do të ishte i barabartë, atëherë vendimtare do të ishte vjetërsia. Si organ i emërtesës, nëse do kisha dy kandidatë që do të kishin pak a shumë pikë të barabarta, natyrisht do të zgjidhja atë që ka më shumë vjetërsi sepse ai më i riu do të ketë raste të tjera. Natyrisht, me kalimin e moshës, edhe matura dhe mençuria rritet. Natyrisht për këtë duhet Gjykata Kushtetuese, dmth. për maturinë dhe mençurinë, duke qenë si organ drejtues dhe normues në shtet. Por, 12 pikët që janë caktuar këtu janë shumë lart dhe përfundimisht është parimi evropian që nuk duhet të jetë vendimtare vjetërsia, por duhet të merret parasysh në aspekte të tjera.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe parashtron se i kam studiuar me vëmendje varianetet, si atë të përgatitur si projekt nga EURALIUS edhe këtë të përgatitur nga ju zoti relator dhe strukturalisht unë i gjej të njëjta të dyja tabelat. Ashtu siç kam thënë edhe në dy mbledhjet më parë, Këshilli duhet të tregojë shumë kujdes pikërisht për këto tabela që bëhen pjesë të vendimit edhe për një arsye tjetër. Me miratimin e këtij vendimi dhe të shtojcave bashkëlidhur, ky akt do

të publikohet. Me publikimin merr rëndësi sepse nëpërmjet kriterëve ose peshës secilit nga tre blloqet jepet një mesazh në publik që ne po kërkojmë një gjyqtar kushtetues më shumë të kësaj natyre dhe me pak të kësaj tjetre. Duke parë pikëzimin tek meritat profesionale si strukturë më pelqen ideja që u tha se ky Këshill, bazuar në këtë strukturë, duhet të ndajë në parim se çfarë peshe duhet ti jepet secilit dhe në vlerësimin tim, duke parë paraprakisht këtë strukturë të ndarjes së pikëve, mendoj që i është dhënë më tepër, është mëshuar më tepër tek një gjyqtar më shumë profesional sesa i vlerësuar me pikë për anën e tij morale. Ndërkohë që ajo që është pikërisht kriteri moral është një nga ato që dikton ose ndikon mbi mënyrën e gjykimit të gjyqtarit në gjykimin kushtetues, ndikon tek vendimi i gjyqtarit si ai e zgjidh çështjen pavarësisht sa i aftë është ai profesionalisht. Në qoftë se aftësia profesionale edhe mund të korrigjohet nga konsulta me kolegët apo nga këshilltarët që e asistojnë gjyqtarin, cilësitë morale pastaj janë gjë tjetër. Në këto kushte unë do të vlerësoja që kriteri moral ti jepej më shumë peshë, duke shtuar edhe burimet apo indikatorët e kriterëve që do përfshihen në këtë bllok. Përsa i takon aftësive organizative shkojmë në të njëjtën llogjikë se një gjyqtari kushtetues mund ti bjerë rasti të jetë kryetar dhe niveli i pikëve me 10 nuk më duket tepër i ekzagjeruar. Ndoshta mund ti zbrisim dy pikë por jo aq shumë sepse është një normalitet. Ndërsa tek raporti tjetër, 70 me 20 pikë, duhet që të rritet pesha e kriterit moral. Të mbahet parasysh, kur pikët vjetërsia në profesion si term i përgjithshëm ose përvoja si jurist. Në vijim do të kemi edhe komente të tjera.

Mimoza Arbi, merr fjalën dhe parashtron se më pelqen kjo mënyrë ndarje sepse për mua ka rëndësi aftësia profesionale në radhë të parë, natyrisht edhe ajo morale. Pak a shumë ato që kanë kërkuar për tu bërë gjyqtare të Gjykatës Kushtetuese, të paktën nga listat që janë shpallur, dihet që kanë aplikuar pothuajse mbi këtë kriter që e kanë plotësuar. Në kushtet kur jemi në një terren kur kemi dhe aplikantë që kanë aplikuar dhe dihen se kush janë ata, KED për ti renditur në atë treshen primare duhet të ketë bazë aftësinë profesionale e bazuar natyrisht jo vetëm tek përvoja, por edhe tek elemente të tjerë që janë përshkruar këtu. Ndoshta diferenca s' duhet të jetë kaq e madhe në pikë.

Anëtarët e Këshillit, pas këtij diskutimi në parim, orientohen dhe zhvillojnë diskutimin mes tyre pikësëpari mbi raportin e shpërndarjes së pikëve ndërmjet tre kategorive të meritave: profesionale, morale dhe menaxhuese dhe dokordësohen për rritjen e pikëve në meritat morale. Mbahet parasysh edhe dallimi mes raportit të pikëve në Shtojcën e pikëzimit për Gjykatën Kushtetuese, nga ajo për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu, ndërmjet dy varianteve të pikëzimit, pra me skemë zbritjeje nga prezumimi i maksimumit apo me skemë caktimi pikësh drejt maksimumit, Këshilli vlerësoi të zgjedhë variantin e dytë.

Agnes Bernhard (*përkthen përkthyesja*), pas diskutimeve me anëtarëve, kërkon fjalën dhe parashtrohet se doja vetëm të cilësoja diçka që parashtohet në ligj në lidhje me menaxhimin. Sigurisht nuk lidhet me atë sesi të menaxhojmë një kompani. Por, është aftësia psh. për të marrë vendime. Unë kam patur një kolege në panelin tim që nuk ishte në gjendje të merrte një vendim. Pra, ky është një tipar karakteristik edhe për gjyqtarët. Edhe aftësia për të punuar në grup dhe në ambiente multidisiplinore. Është e rëndësishme sepse në Gjykatën Kushtetuese kemi panele gjyqtarësh, pra ata nuk veprojnë në mënyrë të shkëputur nga njëri tjetri. Pra e rëndësishme është të kemi edhe komunikim si aftësi që çdo gjyqtar duhet ti ketë. Prandaj, unë mendoj që është mirë që ti japim rëndësi dhe ti japim disa pikë edhe këtyre meritave, por jo shumë.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe parashtrohet se dëgjova pak më parë se me rritjen e peshës së meritave morale mund të rritet mundësia e subjektivizimit në vlerësim. Unë nuk e shikoj kështu sepse po të ishte për subjektivizim edhe në vlerësimin e aftësive profesionale mund të ketë. Veç asaj, edhe dhënia 20 pikë është problem po të ketë subjektivizim. Nuk është se po zgjidhni gjyqtar kushtetues që janë 65 % profesional, 30 % moral dhe 10 % drejtues.

Anëtarët e Këshillit, pas këtij diskutimi përcaktojnë se shpërndarja e pikëve ndërmjet tre grupeve të meritave të jetë 60 pikë për meritat profesionale, 30 pikë për meritat morale dhe 10 pikë për meritat menaxhuese, komunikimit etj.

Këshilli ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër.

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Mbledhja e Këshillit, pas pushimit, vijon me shqyrtimin dhe diskutimet rreth strukturimit dhe renditjes së kriterëve të shpërndara në tre nëndarjet të meritave profesionale, si edhe mbi shpërndarjen e pikëve brenda kategorisë së meritave profesionale. Në projektshtojcën për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese propozohet një nëndarje në tre pjesë: (A) vjetërsia në profesion dhe përvojat e veçanta 20 pikë, (B) veprimtaria dhe aftësitë e spikatura profesionale 20 pikë, (C) aftësitë e përgjithshme profesionale 30 pikë.

Anëtarët e Këshillit, në diskutimet e tyre, në parim, dakordësohen për ndarjen e kriterëve dhe shpërndarjen e pikëve në tre nëngrupet e sugjeruara me disa ndryshime për të riparuar mbivendosjet e kriterëve, peshën e tyre dhe të pikëve përkatëse, si edhe për zbritjen e një pjesë të pikëve nga nëngrupi Vjetërsia në profesion duke i kaluar tek meritat morale.

Agnes Bernhard (*përkthen përkthyesja*), pas diskutimeve me anëtarëve, kërkon fjalën dhe parashtrohet se kemi të njëjtin mendim dhe shqetësimin e kolegëve që shikojnë mbivendosje të kriterëve. Nëse shikojmë titujt duket sikur kanë mbivendosje. Në seksionin A është përvoja e

veçantë në fusha të caktuara të së drejtës. Në seksionin B veprimtaria në sfera të caktuara në të së drejtës. Ndërsa në seksionin C përmbahet vlerësimi i përgjithshëm që duket sikur përfshin elementë edhe nga ato që u përmendën më parë. Duhet pasur parasysh që në Gjykatën Kushtetuese nuk duhen vetëm gjyqtarë që të kenë njohuri specifike a të specializuar vetëm në të drejtën kushtetuese dhe të drejtave të njeriut por edhe nga ata me njohuri të posaçme a të specializuar në sfera të tjera të së drejtës. E drejta kushtetuese mundet të ketë një lloj avantazhi karshi sferave të tjera të së drejtës, por në Gjykatën Kushtetuese nevojiten edhe nga fusha të tjera të së drejtës, ndaj edhe kandidatë të tillë mund të marrin pikë dhe të barazohen me të parët. Prandaj, mund të themi që specializimi në të drejtën kushtetuese dhe të drejtat e njeriut, me është specializimin për sfera të tjera të së drejtës duhet të jenë të ballancuara mirë kur vjen fjala për pikëzimin. Seksioni A mund të ngushtohet shumë dhe ti referohet vetëm vjetërsisë. Domethënë ti qëndrojmë këtij strukturimi mirëpo të bëjmë disa zhvendosje, disa transferime, në mënyrë që të shmangen mbivendosje. Dhe gjithashtu pikëzimi duhet të jetë i tillë, në mënyrë që ti jepet rëndësi e madhe specialitetit dhe cilësisë së madhe në një sferë të caktuar, duke patur parasysh specializimin në të drejtën kushtetuese, gjithashtu dhe specializimi në sfera të tjera të së drejtës dhe gjithashtu vjetërsia në tërësi. Përvoja që lidhet me qenien këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese apo në Gjykatën e Lartë thjesht duhet të jetë si një nga burimet duhet të jetë thjesht një nga shembujt njësoj siç janë veprimet për punën kërkimore e të tjera me rradhë pra të jetë pjesë e këtij grupi. Domethënë ekperiencia specifike duhet të jetë komplementare. Ndërsa kur themi aktivitetet e spikatur, këtë unë do ta shikoja më shumë në vlerësimin e performancës. Në fakt ky mund të jetë dhe kriter kualifikues, ai që nuk e ka këtë nuk duhet të kalojë. Nëse dikush nuk spikat në punën e vet, nuk është i njohur, në vlerësimin e përgjithshëm ai duhet që të përjashtohet dhe nuk merr pikë shumë. Ndërsa dikush që ka këtë eksperiencë dhe është i dalluar gjithashtu ka edhe këtë eksperiencën kushtetuese natyrisht do marrë më shumë pikë.

Kur bëhet vlerësimi i aftësive profesionale sipas këtyre kritereve, si burime dhe metoda vlerësimi duhet të merren parasysh dokumentat që ka paraqitur kandidati duke vlerësuar se kush është më origjinal, si edhe impakti i punës së tij. Po kështu, aftësia për ta argumentuar me llogjike dhe për të bindur, për të qënë i saktë dhe jo për të humbur në prezantimin e një argumentimi. Ose aftësitë kërkimore, sa mund të shkosh në analizën karahasuese psh, në praktikën gjyqësore apo në të drejtën ndërkombëtare pra kjo e dallon profesionistët. Këtë do ta vendosja si 'a', dhe këtu do isha dakord e ta vlerësoja me 30 pikë sepse kjo është më e rëndësishmja. Pastaj mund të shikoja ekspertizën në të drejtën kushtetuese në publikime, përfaqësime çështjesh në Gjykatën Kushtetuese ose në Gjykatën e Strasburgut etj. Ndërsa për sferat e tjera duhet patur parasysh që një kandidat që mund të ketë ekspertizë shumë të mirë në

një sferë të caktuar të ligjit që është e dobishme për shoqërinë. Unë kam punuar në Gjykatën Kushtetuese në Austri, nuk do të ishim në gjëndje të punonim nëse nuk do të kishim këtë larminë e eksperiencave sepse sferat e ligjit janë kaq komplekse, aq më tepër me pranimin e së drejtës së BE. Ekspertizat dhe njohuritë që sjellin anëtarët e Gjykatës Kushtetuese janë një vlerë e vërtetë dhe natyrisht që duhet të merret parasysh në vlerësim. Meqënëse është e tillë, atëherë pikët më të shumta duhet jepen tek cilësia që e këtyre profesionistëve. Atëherë, vjetërsia është vjetërsi, këtu mund të shtohet edhe trajnimi vazhdues ose karrierën akademike që ka patur kandidati. Pra, nuk ke vetëm eksperiencën profesionale por merren parasysh edhe trajnimet e mundshme që ai mund të ketë për të bërë gjatë kohës dhe këto mund të jenë me certifikatë. Natyrisht duhet të patur kujdes me këto dokumentet sepse nëse dikush të vjen me 100 çertifikata dhe të thotë kam qenë tek Euralius dhe në organizata të tjera në trajnime. Por ato duhet të përfundojnë më një vlerësim dhe jo thjesht me një pjesëmarrje formale. Nëse dikush më vjen më një doktorature natyrisht ai meriton më shumë pikë. Por këto janë hollësi, duhet bërë kujdes se jo çdo çertifikatë dhe jo çdo diplomë tregon cilësi në profesionin përkatës.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe parashtron se mua më pëlqen nënndarja në tre blloqe, realisht. Për të disatën herë, siç e cituat edhe juve kryetar, ky organ ka konstatuar se ligji ka boshllëqe dhe të meta. KED-ja vihet sërish në një momet delikat për të vlerësuar dallimin midis eksperiencave apo përvojës në një fushë të caktuar të së drejtës apo një pozicioni që i jep ligji këshilltar ligjor në gjykatën Kushtetuese. Në një situatë incidentale, këto norma duhet të shkojnë në Gjykatën Kushtetuese dhe të shfuqizohen. Kjo është diskriminuese, në vlerësimin tim. Mund të ketë ardhur nga pasojat që në grupe pune mund të kenë marrë pjesë këshilltarët ligjor të Gjykatës Kushtetuese, kandidatë sot. Ta themi hapur këtë. Kështu që Këshilli vendoset në një vështirësi sot për të bërë diferencën e pikëzimit midis këtyre dy kriterëve pikërisht për këtë defekt të ligjit. Një zgjidhje mund të ishte ndarja e kësaj, rreshtit të dytë, në e vlerësojmë me 8 pikë se thotë ligji ose atëherë ta ndajmë me dy pjesë. Katër për këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese dhe 4 pastaj për të tjerët, për të ruajtur një balancë aritmetike. Për pjesët e tjera kjo mund të realizohet ose duke relativizuar pikët midis këtyre ku ka mbivendosje ose duke i shkruar fare dy prej tyre në një të vetme.

Enio Haxhimihali, merr fjalën dhe parashtron se sikurse tha përfaqësuesi i Institucionit të Presidencës për të dytën herë, në mbledhjen e sotme por edhe dje, na dolën problemet e ligjit. Pra kur ligji mund të ketë një paqartësi dhe boshllëk ne si Avokat Populli mbajmë një mendim disi ndryshe. Nëse ne konstatojmë si organ, këtu konstatohet nga ju ose nga përfaqësuesit vëzhguesit një problem ligjor, pse mos të bëjmë përpjekje për ti përmirësuar sepse ligjet sigurisht janë të mira por e mira s'ka fund. Nëse është problem ligjor a do ta zgjidhim ne me akt nënligjor

për shkak të paqartësive të ligjit? Nëse ligji ka nevojë për përmirësim kemi përfaqësues të Kuvendit, ka institucione të tjera që mund ta adresojnë këtë. Kjo ishte vërejtja e parë dhe nëse më lejohet dhe një koment për këtë diskutimin e diferencës ndërmjet nenit 125 pika 4 dhe shkronjës 3 pika “b”. Ka një kriter 15 vjeçar në rastin e nenit 125 pika 4, ndërsa në rastin e këshilltarëve ligjor të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, nuk ka një kriter vjetërsie të tillë. Pra ai mund të ketë filluar edhe para pak kohësh. Ne dimë që funksioni gjyqtar e prokuror kalon në disa filtra, ndërsa filtrat që zgjidhet një këshilltar kanë qenë më të thjeshta se sa filtrat për t’u zgjedhur gjyqtar.

Anëtarët e Këshillit, vijojnë diskutimet mes tyre dhe dakordësohen që ndarja në tre nëngrupe të kritereve të meritave profesionale duke orientuar sistemin e tyre duke vendosur si Seksion A vjetërsinë në profesionin historikun arsimor, trainimet, kualifikimet pasuniversitare, titujt akademikë dhe gradat shkencore. Në Seksionin B vlerësimin e përgjithshëm profesional me më shumë pikë dhe peshë dhe Seksionin C me cilësitë shtesë profesionale. Peshat specifike dhe pikët të shpërndahen sipas rëndësisë së këtyre nëngrupeve dhe kritereve dhe në mënyrë sa më të balancuar.

Për reflektimin në projektakte të çështjeve të dakordësuara në mbledhjen e sotme, Këshilli vlerësoi të punohet bashkërisht me ekspertët e Euralius dhe projektet e përmirësuara ti paraqten për shqyrtim dhe vlerësim Këshillit në mbledhjen e ardhshme.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi merr mendimin e anëtarëve për rendin e ditës dhe kohën e mbledhjes së ardhshme, duke u përcaktuar zhvillimi i saj në datën 02 Prill, në orën 12.00, për të vijuar me diskutimet për të njëjtin rend dite: *Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Shtojcat e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidaturave*, deklaroi mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 14.46

Sekretare

**Dorina Dulaj
Ermelinda Kadiu
Redjona Myrtja**

Kryetari

Ardian Dvorani

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga personel i vetë institucioneve të ftuar.